



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Më datë 01.04.2008, në ora 11:00;
Salla N-10;

Komisioni për
Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Procesverbal

Mbledhjen e drejtoi
Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit

Morën pjesë: Slobodan Petroviq; Safete Hadergjonaj, Sala Berisha-Shala, Mufëra Şinik,
Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi, Zef Morina dhe Berim Ramosaj;
Mungoi: Ethem Ceku, Haki Shatri;

Nga zyra mbështetëse: Advie Morina;

Të ftuar: Kryetari i bordit të ART-së; Përfaqësues nga Ministria e transportit dhe
Telekomunikacionit, edhe Përfaqësuesit Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;

Përcjellës prezent: Haxhi Gashi nga USAID-i, Vjosa Bajraliu nga KDI-ja;

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/ L-5 për Mbështetjen e Ndërmartjeve të vogla dhe të mesme;
3. Shqyrtimi i raportit të ART-së;
4. Të ndryshme;

Me propozimin e kryetares komisioni u pajtu me këtë rend dite.

1. Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës, miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluara u miratua ne parim,vërejtje pati Sala Berisha-Shala, vërejtjet e së cilës u vendos që të përcjellen te stafi ligjor i komisionit në formë të shkruar.

2. Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi i P/L për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, raportesa e grupit punues për këtë projekt ligj propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës pasi që grupi punues nuk kishte përfunduar punën.

Rendi i ditës u miratua me ndryshim që pika e dytë të shtyhet për mbledhjen e radhës;

III- Shqyrtimi i raportit të ART-së;

Kryetarja – njoftoi anëtarët e Komisionit që prezent në mbledhje është z. Anton Berisha, Kryetar i Bordit të ART-së. Të cilit ia dha fjalën për prezantimin e Raportit të Strategjisë Kombëtare për Implementimin e FEA në brezat frekuencore 3.5 GHz.

Anton Berisha (Kryetari i bordit të ART-së) – në fillim të prezantimit të raportit e falënderoj Komisionin për ftesën e bërë, në lidhje më dokumentin konsultativ Fixed Wireless Access (FWA). Z.Berisha theksoi se dokumenti i është shpërndarë për konsultim institucioneve edhe palëve që janë në tregun e telekomunikacionit, duke përfshirë edhe institucionet akademike për shkak të peshës së dokumentit në zhvillimin të ashtuquajturës FWA-së, duke e vlerësuar si dokument më shumë rëndësi dhe e konsideroj si një progres të përgjithshëm dhe mbështeti bazën ligjore konform ligjit të telekomunikacionit dhe në bazë të dokumentit të aprovuar nga qeveria si politika të sektorit të telekomunikacionit, për shkak të zhvillimeve dhe të shërbimeve brez gjëra.

Ai potencoi se në fushën e brezit të gjerë kemi një situatë momentale të mirë nëpër qytete por e kemi një situatë jashtëzakonisht të dobët nëpër zonat tjera dhe qëllimi është mbulimi i tërë territorit. Duke shtuar se ky dokument është bazuar në praktikën më të mira të shteteve evropiane dhe rajonale, por gjithsesi është i bazuar në vendimet që kanë dal nga rekomandimet të Komisionit Evropian të ashtuquajtura Rekomandime të Institucioneve Telekomunikuese. Duke pas parasysh që ne kemi një komision i cili wshw i pwrbr nga ekspertet vendoret dhe të jashtëm edhe duke pas parasysh që ne jemi në vitin e pestë dhe departamenti për frekuenca ka arrit një zhvillim të mirë, ky dokument është pune prej eksperteve tonë. Këtë ekip e ka udhëheq Ilir Ymeri inxh. i telekomunikacionit dhe është në shqyrtim publik.

Strategjia ka të bëjë më dhënien e katër licencave në nivelin nacional dy here nga 21GHz për secilin operator. Këta e kanë parapa një ndarje plotësuese për operatorin nacional që të jetë 250 mije euro ndërsa operatorët do të jenë të obligim do të thotë problemi me i madh i implementimit do te jete imponimi në zona rurale dhe kompanitë e shohin me pak fitimprurëse investimin dhe ne do te qëndrojmë që në mënyrë të barabartë të përqendrohen në të gjitha zonat dhe jo vetëm ne zonat ku ka koncentrim te banorëve dhe fitim. Z.Berisha tha më tej se është parapa një raportim prej gjashtë muajve dhe çdo dispozitë që flet për shfrytëzimin e brezit frekuencor në çmim prej 75 mije euro. Tani presim reagime të palve për çmimet nga se kemi një kërkesë nga Komisioni evropian qe

të ulen tarifat, sepse ka një dispozitë ligjore ku thotë se ART-ja financohet vetë, ndërsa teprica shkon në buxhetin e Kosovës, nga se kjo është rezultat i ligjit që bazohet në direktivat e vitit 1998 ndërsa i kam propozuar edhe qeverisë edhe kuvendit rekomandimin që ligji të rridhet sepse tash gjendja në telekomunikacion nuk e duron legjislacionin e vitit 1998 dhe as korniza e vitit 2003, dhe as ajo e vitit 2006.

Sepse në vitin 1998 tregu ka qenë mjaft i varfër ndërsa tani rrethanat kanë ndryshuar dhe kemi një gjendje tjetër, përfundoj prezantimin z.Berisha.

Kryetarja – e falënderoj z.Berisha, për prezantimin dhe ia japi fjalën përfaqësuesve nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Agim Kikaj (Përfaqësuesi i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit) – i shtroj disa pyetje z.Berisha, si më poshtë: 1) a do të ndikoj kjo strategji që ti bëjë konkurrencë telefonisë fikse; 2) si do të trajtohet kjo gjatë implementimit; 3) çmimi orientues a ka pas ndonjë analizë; 4) edhe të çështjet e shtrirjes në zonat jo urbane si do të sigurohet.

Anton Berisha – në përgjigjen e tij theksoi se Ministria e ka Departamentin e Teknologjisë Informative dhe është dashtë të takoheni më përfaqësueset e ART-së që e kanë punuar dokumentin sepse janë departamente kompetente për ti diskutua çështjet në detaje dhe theksoi se në parim edhe ky ligj që është tregu që është i hapur i liberalizuar, operatorët ekzistues duhet që përmes kualitetit edhe çmimeve të imponohen në treg e jo përmes ruajtjes dhe privilegjit që mos të hyjnë të tjerët ku në princip kemi një neutralitet teknologjik ndërsa sa i përket qasjes dhe me rendësi është që të kemi qasje në shërbim.

Kaqusha Jashari – në diskutimin e saj potencoi se kjo strategji me siguri do të miratohet në Kuvend sepse është rregull ndërsa për diskutim këtë strategji duhet të jetë në bashkëpunim më ministrinë përkatëse, ku qeveria me propozon strategjinë zhvillimore dhe të miratohet në Kuvend.

Agim Kikaj (Përfaqësuesi i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit) – paraqiti para Komisionit disa të dhëna të cilat ai i konsideroj si të nevojshme. Ai tha se Ministria i ka hartuar politikat e saja dhe njëra prej politikave detyruese për ART-ën, është edhe çështja e liberalizimit të tregut e posaçërisht të shfrytëzohet në mënyrë efektive dhe efektive resursin më të çmueshme natyror spektri frekuencor.

ART-ja e ka hartuar këtë draft teknikisht, nga se çështje të rregullohet më ligj, gjendja me 3.5 GHz është alarmante edhe pse është në krah rajon, mirëpo kemi entitete të ndryshme kemi përgjegjësi të ndryshme, dhe se di si ka me iu dhanë dikujt ky brez pa u spastrua, potencoj z. Kikaj. Ne duhet me marr vendim strategjik dhe më përkrah ART për me i nderu kapacitetet për më monitorua dhe me menaxhuar spektrin frekuencor.

Në anën tjetër Komisioni i Pavarur për Media i cili po pretendon edhe në draftin e Kushtetutës që ai me menaxhu spektrin frekuencor, dhe kërkoj që në këtë komision dhe më ART-ën dhe ne si Ministri ta zgjidhim këtë situatë se kujt i takon të menaxhoi më brez. Çështja tjetër që potencoj ishte edhe licencat katër operatorëve. Po ashtu ai propozoj që financimi i ART-së duhet të rregullohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Zef Morina – në diskutimin e tij theksoi së është jo e arsyeshme raporti ne mes ART-së dhe Ministrisë, sepse kemi një shkëputje të bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve dhe bëri të qartë se ligji e obligon ART-ën duhet të bashkëpunoj ngushtë dhe ti respektoj Ministrinë dhe ti zbatoj politikat e Ministrisë.

Pastaj e pyeti z.Berisha se çfarë po behët për hapjen e tenderit për telefonin fikse?

Berim Ramosaj – në diskutimin e tij theksoi se dokumenti teknik që e ka propozuar ART-ja, mund të jetë për neve një informacion në kuptimin e asaj se kah po shkon ART-ja. Ndërsa sa i për këtë raportit mes Ministrisë dhe ART-së, theksoi se nuk është çështja jonë mirëpo kur është çështja e zhvillimit të politikave, në qoftë se janë në harmoni me planin e qeverisë së kaluar fajtor është qeveria e sotme që nuk ka plan zhvillimor dhe nuk e dimë së kah është e orientuar kjo qeveri.

Zef Morina – sqaroi për të pranishmit se ART-ja, nuk është themeluar nga Kuvendit por prej Ministrisë. Duke shtuar se ne po i shohim gjërat që nuk po shkojnë mirë, dhe komision nuk është vetëm kuadër profesional por edhe politik dhe duhet me marrim vendim.

Anton Berisha – në përgjigjen e tij sa i për këtë raportit më Ministrisë, ART-ja i raporton Kuvendit në qershor dhe kjo është e paraparë më ligj, pastaj aprovohet apo nuk aprovohet strategjia kjo nuk është çështja e jona por e Kuvendit.

Safete Hadergjonaj- tha se Komisioni për ETIETT e ka marr në shqyrtim dhe nuk e sheh si asgjë të keqe që ky raport të diskutohet edhe në Kuvend. Duhet të kemi shumë kujdes që mos ti shiqojm ato se si vetëm të japim licenca edhe pse dikush është i interesim vetëm më dhëne licenca sepse e sheh aty përfitimin e vet, mirëpo sa do të jetë e zbatueshme dhënia e këtyre licencave. Prandaj propozoi që kësaj strategjie ti bashkëngjitet edhe disa sqarime dhe analiza tjera të cilat do të ishin bindëse. Dhe mandej të bihen ne Komision dhe të harmonizohen politikat edhe me ministrisë dhe të diskutohet në Kuvend.

Agim Kikaj (Përfaqësuesi i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit) – tha se nuk janë respektuar procedurat që duhen zbatuar sipas ligjit në përpilimin e raportit, duke sqaruar se më 5 korrik 2007, Ministria i ka dërgua ART-së ku shkruhet qartë se ART-ja është i obliguar që brenda 3 muajve ta bëjë planin aksional për implementim e politikave dhe nuk është kthyer asnjëherë përgjigje. Dhe propozoj që hapi i parë është të behet plani aksional i politikave, nga se pa aprovim të këtij plani nuk mund të shkojmë më tej duke kërkuar nga Komisioni me ndërhy për të ndryshuar gjendjen.

Anton Berisha – në fund fare foli për përparimet në fushën e telekomunikacionit duke krahasuar çmimet e kartelave në të kaluarën me të tashmen, pastaj futjen e signalit ndërkombëtar të SMS, MMS, etj. Ai propozoi që të formohet një komision i përbashkët ku do të jetë: një përfaqësues i komisionit, një përfaqësues i Ministrisë dhe një përfaqësues i ART-së për ti sqaruar çështjet në të ardhmen.

Kryetarja – konsideroj që kjo çështje të shqyrtohet në Kuvend për strategjinë e implementimit të politikave dhe kuvendi do të merr vendimin e prerë. Ajo tha se Komisioni është për monitorim e Ministrisë dhe Agjencive tjera.

Pas diskutimeve anëtarët e Komisionit nxirren këtë:

Përfundim

Raportet midis Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe ART-së, të funksiononin sipas ligjit ndërsa strategjia e ofruar është bazë e rëndësishme informative për Komisionin;

III – Të ndryshme;

Në pikën e fundit të rendit të ditës Kryetarja e Komisionit i informoi anëtarët e komisionit për kërkesën e Kryesisë së Kuvendit në lidhje me tërheqjen e disa projektligjeve të miratuara, si më poshtë:

- Ligjit për ngrohje qendrore
- Ligjit për miniera dhe minerale, dhe
- Ligjit për hulumtime gjeologjike.

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan Sala Berisha-Shala, Berim Ramosaj dhe Fatmir Rexhepi.

Pas diskutimeve anëtarët e Komisionit nxirren këtë:

Përfundim

Të bashkangjitet arsyeshmëria Kryesisë së Kuvendit dhe e Ministrisë përkatëse, dhe të ftohen të raportojnë në lidhje me kërkesën e tërheqjes së këtyre ligjeve;

Poashtu Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit se poashtu kemi një shkresë të Kryesisë së Kuvendit lidhur me koston e projektligjit për Ujërat e Zeza.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40;

Kryetare e Komisionit:
Myzejene Selmani